Ekonomia e varfërisë

ose: Pse nuk dalin ata nga mjerimi?

As në Pata-Rât nuk janë të gjithë njësoj. Gabrieli, një burrë rreth të dyzetave, është aq punëtor dhe ka aq shpirt iniciative, saqë mund të matet me çdo lloj menaxheri. Fjalitë që lëshon nga goja, ky burrë i fortë dhe lidhur, i shoqëron me një buzëqeshje dhe kur është duke treguar diçka i lëviz duart sikur është duke i dhënë varkës. Para shtëpizës së vogël ka ndërtuar një verandë, të cilën e shtron vetë me pllaka ngjyrë të kuqe të hapur. Mallin që vjen e kontrollon me kujdes, dhe krenaria e tij e veçantë është kuzhina me dollapët dhe sirtarët me shkëlqim. Por ka edhe njerëz të tjerë këtu. Elena për shembull, një grua e thatë 52-vjeçare, e ka varfërinë të shkruar në fytyrë. Ajo flet me zë të ulët dhe të dobët dhe është aq e druajtur saqë nuk e shikon bashkëbiseduesin në sy. Pjesën më të madhe të kohës ajo rri vetëm duke pirë cigare para kasolles së saj, të ndërtuar me dërrasa që mezi mbahen.

Si gjithë njerëzit e tjerë në kasollet e lagjes së vogël, edhe Elena dhe Gabrieli mbledhin në deponitë e plehrave, gjërat që nuk u hyjnë më në punë qytetarëve. Në Pata-Rât jetojnë „njerëzit e plehrave“, siç quhen me kuptim të dyfishtë njerëz të tillë në reportazhet që bëhen për Rio de Zhaneiron ose Buenos Ajresin. Kur një makinë me plehra ndalon para hyrjes së deponisë së plehrave, të parët që hipin në të janë fëmijët që rrëmojnë mes gjërave përpara se shoferi të arrijë vendin ku i derdh ato. Në lagjen e ndërtuar në shpatin e pirgjeve të plehërave, ndodhen kasolle prej dërrase, kartoni dhe pllakash

plastike. Reshjet kanë hapur rrjedha e tyre në rrugicat midis kasolleve, por edhe përmes katramave të çative. Njerëzit kalojnë aty me çizme gome, ose zbathur; çdo gjë tjetër nuk do të kishte kuptim.

„Varfëria më e madhe në qytet vjen prej povertesë së madhe“, thotë nëpërmjet heroit të romanit të tij poeti Fritz Reuter, megjithëse lexuesit e tij në shekullin e 19-të e dinin se pauvreté ishte termi francez për varfërinë. Nga pikëpamja analitike shprehja nuk është dhe aq bindëse. Por ajo tregon në mënyrë shumë precize përvojat e përditshme të njerëzve nga Pata-Rât. Kush është i varfër duhet ta paguajë çdo gjë shtrenjtë. Shumë të kërkuara në pirgjet me plehra janë shishet, sepse në qytet dikush i blen ato. Për suksesin e biznesit vendos kapaciteti i transportit. Disa vetë këtu përdorin karroca dore. Gabrieli ka një automjet me targa të zhvleftësuara, por në gjendje për të lëvizur. Kurse Elenës i duhet t'i mbajë të gjitha në çantë. Vetëm kush i jep makinës, mund të bëjë para me mbledhjen e shisheve. Sa më shumë para të kesh aq më pak e kushtueshme bëhet jeta. Kush ka energji elektrike për shembull mund të fillojë diçka me një frigorifer, dhe kush ka një frigorifer, mund të fusë në të mallra të cilave u ka kaluar afati, mallra që i merr nga kontejneri mbrapa supermarketit.

Disa vetë në Pata-Rât-a e marrin rrymën nga bateritë e automjeteve që gjejnë në plehrat e hedhura, gjë që ka shkaktuar edhe zjarre. Lidhja me rrjetin legal të energjisë elektrike, ose regjistrimi sipas ligjit i automjeteve, apo marrja e patentës së shoferit, nuk mund të bëhen pa para. Problemi më i madh me rrobat është se në dimër ato nuk mund t'i thash. Nëse megjithatë i lan, sëmuresh dhe nëse nuk i lan, atëherë fillon të qelbesh erë dhe gjithë të tjerët të largohen. Kush do të dalë nga kjo vrimë, përdor si mjet edhe shkallën e kalbur të aktiviteteve ilegale. Gabrieli ka kryer disa dënime me burg. Por Gabrieli është më i suksesshmi në Pata-Rât. Ata

që jetojnë këtu e quajnë lagjen e tyre Dallas, sepse edhe këtu gjërat zhvillohen me të njëjtën mungesë sentimentaliteti si në metropolin e naftës.

Pjesa më e madhe e romëve janë të varfër. Në Rumani dhe Bullgari gati 80 përqind e tyre jetojnë me të ardhura që janë më pak se 4,30 dollarë amerikanë në ditë, në Hungari kjo shifër është 40 përqind. Mes burrave romë të moshës 15 deri 64-vjeçare në Hungari, këto të ardhura sado të ulëta nuk i ka as një e treta, tek gratë as një e gjashta. Askund në Evropë nuk vihet në diskutim se mes romëve sundon varfëri e madhe dhe pjesërisht ekstreme. Arsyet pse me gjithë „dekadën rome", me gjithë „planet e shumta të aksioneve" në nivel kombëtar dhe me gjithë fokusimin e Bashkimit Evropian tek kjo çështje, gjendja nuk po përmirësohet, janë bërë objekte të një polemizimi të madh Lindje-Perëndim. Në Lindje thuhet se problemi është tek sjellja dhe kultura e romëve, të cilët nuk duan të punojnë, të dërgojnë fëmijët në shkollë, që i harxhojnë të gjitha paratë menjëherë dhe që pinë shumë. Në Perëndim thuhet se problemi qëndron tek diskriminimi nga filistinët racistë. Nga pak të vërtetë ka tek të dyja këto arsyetime. Por në thelb të argumentit të dyja janë të gabuara.

Integrim me metoda komuniste

Sociologu nga Bukureshti, Catalin Firuam, i datëlindjes 1941, është përfaqësues i qëndrimit lindor. Pas rënies së regjimit të Çausheskut, ai së bashku me të shoqen Elenën, ndërmori studimin më të madh mbi gjendjen e romëve në Rumani. Në fakt, studimi i tij duhet të kishte si rezultat një program kombëtar. Por, kjo nuk ndodhi. „Fajin", thotë Zamfiri njëzetë vjet më vonë, „e ka nga njëra anë ekonomia, pra nuk kishte para". Por, fajin e ka edhe politika e Perëndimit, e cila i përdori në mënyrë të gabuar paratë ekzistuese të ndihmave

– pra për mbrojtjen nga diskriminimi.“ Më zuri goja lesh gjatë takimit të një raundi ekspertësh të zhvilluar në Këshillin e Evropës me sociologë, antropologë dhe politikanë. Ndërkohë që ata nga Lindja tërhoqën vëmendjen për gjendjen ekonomike dhe sociale të romëve, për ata të Perëndimit kishte rëndësi vetëm lufta kundër diskriminimit. Catalin Zamfir nuk i urren ciganët, përkundrazi, madje nuk është as i mendimit se nuk ka problem që romët të diskriminohen. Vetëm, se ai beson se diskriminimi është pasojë e situatës sociale. Në Perëndim shumica beson se është e kundërta. „Unë nuk kam asgjë kundër pranimit të romëve, siç e kërkojnë gjithnjë ata në Perëndim,“, thotë Zamfiri. „Vetëm se kjo nuk ndihmon në zgjidhjen e çështjes.“

Siç mendon Zamfiri mendojnë pjesa më e madhe e njerëzve në Evropën Lindore, pavarësisht nëse i urrejnë romët apo u vjen keq për ta. Supozimi se ata i ndjekin dhe i torturojnë romët, luan një rol kryesor në mes shumë fyerjeve që evropianolindorëve u është dashur të durojnë nga ana e perëndimorëve, qysh prej ndryshimit të sistemeve në vitin 1990. Njerëzit e thjeshtë mendojnë se në fund të fundit fajin e kanë romët vetë dhe se të gjithë ata që tundin me aq zgjuarsi flamurin e të drejtave të njeriut, duhet ta provojnë një herë të jetojnë derë më derë me këta ciganë – si ajo gruaja nga Gyöngyöspata në Hungari, së cilës dikush i kishte vjedhur brenda dy vjetësh dy pula dhe që mendon, se nuk do të ishte keq që romët e fshatit të saj, t’i çonin që të jetonin tek tre kryeministrat e fundit hungarezë. Ky është varianti dashakeq, të cilit mund t’i kundërvihesh lehtë. Catalin Zamfiri nuk mendon kështu, megjithatë ai reagon po kaq alergjik ndaj fushatave perëndimore kundër diskriminimit të romëve në Evropën Lindore. Ai tërheq vëmendjen se romët janë sot „krejtësisht të përjashtuar nga sistemi“. Për të vuajtur prej diskriminimit, romët duhet të kenë kontakt me njerëzit e tjerë

jashtë lagjeve të tyre të mjerueshme. Për shumë nga nismat dashamirëse Zamfiri ka vetëm përbuzje, kështu për shembull për një program të madh hulumtimi kundër mobbing-ut në vendin e punës. A është më e keqe një gjë e tillë se sa mos të të bëjë askush mobbing për shkak se nuk ke fare punë? Ose parulla e përjetshme, romët duhet të mblidhen dhe të diskutojnë: „Shumë mirë. Po çka të diskutojnë, ju lutem shumë?“ Kur Zamfir-i flet për „sistemin“ prej të cilit romët janë të përjashtuar, ai mendon kryesisht për tregun e punës. Por, fajtori i vërtetë për të është kapitalizmi. Profesor Zamfiri është anëtar i Akademisë Rumune të Shkencave dhe kështu një nga shtyllat e botës ideologjike postkomuniste. Dhe ai ka argumente të qëndrueshme. Në vitin 1990, pas rrëzimit të diktatorit, në Rumani kishte 8,4 milionë vende pune. Sot, ka katër milionë. Jo të gjithë të papunët dhe emigrantët e sotëm janë romë, por gati të gjithë romët janë të papunë ose kanë dalë jashtë vendit. Romët ishin të parët që u pushuan nga puna. Jo vetëm për shkak të paragjykimeve të të tjerëve, thotë Zamfiri, por sepse ata kishin më pak arsim se të tjerët, ose sepse pjesa më e madhe e tyre as që i ishte futur rrugës së përshtatjes me stilin modern të jetës. Politika zyrtare e komunistëve ka pasur si synim „homogjenizimin etnik“ dhe „asimilimin“. Në çështjen e luftimit të varfërisë nuk është se nuk ka pasur suksese. „Në vitet gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë“, thotë Zamfiri i mbështetur në të dhëna solide të nxjerra nga një studim i bërë me më shumë se 3 mijë ekonomi shtëpiake, „romët kishin arsim më të mirë dhe vende pune më të mira se sot.“ Me përjashtimin nga sistemi ata u detyruan nga nevoja, që t'i ktheheshin solidaritetit të klaneve familjare, fshatrave dhe bujqësisë primitive. Niveli i lindjeve u rrit sërish shumë. „Por të paktën do t'u mbesë arsimi“, mendonte Zamfiri në fillim të viteve nëntëdhjetë, „atë nuk mund ta shkatërrosh!“ Por edhe në këtë pikë, thotë me

hidhërim, atij iu desh të mësonte të kundërtën. „Mjafton që të pezullosh linjën e autobusit dhe fëmijët nuk mund të shkojnë më në shkollë. Kaq e thjeshtë është kjo.“Në të vërtetë, gjatë periudhës komuniste pjesa më e madhe e romëve jo vetëm në Rumani, kanë qenë të integruar në marrëdhënie pune. Autobusët e ndërmarrjeve shkonin vend më vend dhe merrnin romët e aftë për punë për t'i sjellë nëpër fabrika, ku në fillim ata fshinin oborrin dhe më vonë punonin tek makineritë. Puna në prodhim ishte një e drejtë, por edhe një detyrim. Ashtu si gjithë të tjerët edhe romët duhet të bëheshin pjesë e „popullit punonjës“; zanatet tradicionale, pak produktive të romëve dhe për më tepër tregtia, madje edhe ajo e vogël, dhe fakti që ata nuk ishin sedentar ngjallnin dyshime tek komunistët.

Komunistët mendonin se me kalimin e kohës ata do të hiqnin dorë nga mënyra e tyre tradicionale e jetesës. Në rast se kjo pjesë e „lumpen proletariatit“ do të mësohej një herë me punën e rregullt, atëherë do të ndryshonin mënyrat e pazakonta të sjelljes së tyre, dhe ata do të jetonin në vende fikse dhe do të bënin kërkesë për të marrë një shtëpi banimi në blloqet e banimit të punonjësve, do të dërgonin fëmijët në kopshte dhe do të bënin kështu jetën e një punonjësi të denjë. Aty ku ndërgjegjja e kërkuar nuk zhvillohej aq shpejt sa duhej, u morën masa. Për shembull në Hungari dhe në Rumani, përmes sekuestrimit dhe shkatërrimit të karrocave me kuaj. Në Çekosllovaki partia ndërmori në mes të viteve gjashtëdhjetë një përpjekje për t'i shpërbërë getot e mëdha rome në lindje të Sllovakisë duke i zhvendosur banorët në pjesën perëndimore çeke të vendit. Në asnjë komunë popullsia rome nuk duhet të ishte më e madhe se pesë përqind.

Kjo strategji e arriti synimin e saj. Në vitin 1960 për shembull në Hungari kishte ende 35 përqind të romëve që ishin pa marrëdhënie të rregullta pune, dhe 32 përqind të tjerë ishin thjeshtë punëtorë që punonin sipas rastit.

Njëzet vjet më vonë nuk pati më pothuajse asnjë rom të papunë. Pjesa e punëtorëve okazionalë ra në 15 përqind, kurse pjesa tjetër prej 85 përqind kishin punë të vazhdueshme. Si pasojë kushtet e jetës filluan të ngjanin shumë me njëra tjetrën. Sa i përket furnizimit me frigoriferë, aparate televizivë dhe automjete transporti, hendeku midis pakicës dhe shumicës filloi të mbyllej.

„Revolucioni i kadifenjtë“ erdhi me fshesë

E përbashkët për komunistët dhe postkomunistët në Evropën Lindore është bindja, se shkaqet e thella të varfërisë dhe margjinalizimit social të romëve kanë të bëjnë me sjelljen e tyre të trashëguar. Në periudhën socialiste partia i vuri vetes si detyrë që t'i edukonte romët e çrregullt duke i kthyer në proletarë të vërtetë. Nëse kjo nuk u arrit plotësisht, atëherë vetëm për shkak të „Revolucionit të kadifenjtë“ të vitit 1990, i cili e ndërpreu projektin papritur.

Kurse sot, bindja e përgjithshme është se secili e farkëton vetë fatin e tij. Ai që nuk do, domethënë se ka. Nga një popullsi së cilës nuk i falet asgjë, nuk shihen me sy të mirë programet e ndihmës për ata që gjoja refuzojnë shkollën, refuzojnë punën, që janë gjoja kriminelë të vegjël, që harxhojnë pa masë dhe janë alkoolikë.

„Revolucioni i kadifenjtë“ erdhi për romët me fshesë; tendenca e integrimit në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore u përmbys menjëherë. Aty ku numri i vendeve të punës u përgjysmua, nuk është nevoja të kesh shumë fantazi për të imagjinuar se pse mes shumë njerëzve që humbën vendin e punës, gjendeshin pothuajse edhe të gjithë romët. Ata bënin punët më të këqija dhe kishin pozicionet më të dobëta në drejtimin e ndërmarrjeve. Ata kishin po ashtu arsimin më të keq. Kur ekonomia e mori sërish veten ngadalë,

kjo ndodhi pa romët. Që para komunizmit ata nuk posedonin asgjë dhe nga privatizimi dhe kthimi i pronave dhe i tokës, dolën duarbosh. Në ekonominë e tregut arsimi ishte edhe më i rëndësishëm se në socializëm. Ajo që kishin arritur romët të mësonin, nuk mjaftonte. Sikurse të mos mjaftonin këto, kur filluan të pakësoheshin vendet e paguara të punës, kudo lulëzoi klientelizmi dhe për romët edhe në këtë rast nuk doli gjë. Ajo që mbetet për tu shpjeguar mund të plotësohet me diskriminim etnik apo „racor". Me më tepër akceptancë shoqërore dhe vlerësim më të madh ndaj romëve, siç kërkon BE dhe Këshilli i Evropës për romët evropianolindorë, vendin e dikurshëm të punës do kishin mundur ta mbanin e shumta njëqind ose dyqind romë. Në vend të tyre do të ishin hequr nga puna një ose dy rumunë. Vetëm në Perëndim bëhet pyetja pse në „vagonin e fundit" të shoqërisë janë të ulur vetëm romë. Ndërsa në Lindje pyetet pse duhet patjetër që vagoni i fundit t`u ngjitet vagonëve të tjerë.

Catalin Zamfir gjykon në mënyrë të balancuar. Në provincën rumune kjo tingëllon krejt ndryshe. „Ciganët këtu nuk diskriminohen", thotë me sy të picërruar Ina Voinea, kryeredaktorja e *Gazeta de Sud* në Craiova, gazetë që nxit njërën pas tjetrës fushata kundër romëve. „Edhe nëse ka diskriminim, maksimumi ky është diskriminim pozitiv." Që romët nuk janë në disavantazh, përkundrazi favorizohen dëgjon të thuhet prej shumë vetëve në Hungari, Rumani dhe Bullgari. Kjo natyrisht nuk është e vërtetë. Në të vërtetë në vendet e përmendura, çdokush që „vjen erë" si rom, ka pamjen të tillë, ka një adresë të caktuar ose mban një emër përkatës, nuk ka shanse në tregun privat të punës. Romët nuk merren në punë, as në punët ndihmëse. Njerëzit shesin mend se i dallojnë romët që larg; dhe atyre nuk u vijnë në ndihmë as flokët biondë dhe as sytë blu, po t'i kenë të tilla. Kësaj marrëveshjeje të heshtur i bashkëngjiten madje edhe

kompanitë e mëdha, si për shembull sipërmarrja bijë e koncernit amerikan Bechtel, e cila për ndërtimin e një autostrade kishte nevojë për shumë punëtorë ndihmës. Romëve iu premtua se do t'i merrnin në punë, por ky premtim nuk u mbajt; me argumentin se firma nuk donte të kishte probleme me personelin bazë. Në Filákovo të Sllovakisë, para ndryshimit së sistemit punonin në uzinën e çelikut qindra romë. Edhe sot ata jetojnë në blloqet e banesave përreth, por që kur uzina i është shitur sipërmarrjes amerikane Steel, asnjëri prej tyre punon më aty. Në Sllovaki janë dokumentuar mjaft raste, kur romëve në lokale u vihen në dispozicion hapësira primitive dhe të zhveshura– si në regjimin e Aparteidit në Afrikën e Jugut. Birra disave u serviret në gota qelqi, të tjerëve në kupat prej kauçuku të kosit. Lajmet për muret, me të cilat në Çeki, Sllovaki dhe Rumani ndahen lagjet rome nga zonat e banimit të „të bardhëve", e kanë nxehur rregullisht publikun liberal të Perëndimit, po ashtu si „ndalimi i qëndrimit kot në rrugë", një rregull që kryetari i bashkisë së Rotava-s në Çeki, nxori duke pasur parasysh romët e komunës së tij. Bindja që romët duhet të sterilizohen, në mënyrë që të mos shtohen „si lepujt", mbretëron kryesisht në Sllovaki dhe Hungari, dhe këtë e thonë shumë vetë me vetëdije të plotë dhe pa ndonjë urrejtje të veçantë. Madje mund të dëgjosh që romët duhet „të mbyten me gaz".

Evropiano-lindorët dhe romët e tyre

Diskriminimi dhe përçmimi publik i romëve ka qenë gjë e zakontë që në periudhën socialiste. Strategjia e shndërrimit të atyre që ishin jashtë rregullave të shoqërisë, në anëtarë të devotshëm të popullit punonjës, i bëri romët objekt të pedagogjisë, i ktheu në fëmijë, dhe e bëri popullin shumicë që të merrte rolin e mësuesit. Kush tiranizohej prej mësimeve të

autoriteteve komuniste, dhe detyrohej që të pranonte sistemin kishte mundësi që ta transmetonte zemërimin e tij tek ata që ishin më poshtë. Në fshatrat hungarezë shfaqej një herë në vit ushtria, e cila kryente aksione kolektive larjeje: burra, gra dhe fëmijë duhet të laheshin duke u kruar dhe pastruar mirë para syve të ushtarëve – një poshtërim publik, i cili ndihej si i tillë nga njëra palë dhe që kishte këtë si qëllim nga pala tjetër. Në Çekosllovakinë socialiste grave rome iu ofroheshin para, që të sterilizoheshin. Trajtimi i romëve ka qenë për çudi më liberal në fazën staliniste.

Pas mesit të viteve pesëdhjetë në vendet e Evropës Lindore si në Çekosllovaki, po ashtu si në Poloni, Bashkimin Sovjetik, Hungari dhe Rumani, përpjekjet e druajtura për emancipimin kulturor të romëve, si për shembull klubet, teatrot, shoqatat e tyre ia lanë vendin një politike rigoroze asimilimi. Në Bullgari komunistët i mbyllën të gjitha institucionet rome. Pjesës më të madhe të atyre që ishin myslimanë si dhe turqit, iu desh të ndryshonin madje emrin, duke marrë emër sllav. Në Rumani, për romët nuk flitej fare, dhe ata nuk numëroheshin krahas „nacionaliteteve të tjera që bashkëjetonin“ si për shembull hungarezët dhe gjermanët. Ky nuk ishte „diskriminim“ në kuptimin e vërtetë të fjalës, sepse romët nuk duhet të „diskriminoheshin“, prej të tjerëve, pra të dalloheshin prej tyre. Por, siç ndodh shpesh, nën mbrojtjen e barazisë së shpallur, bëhej i mundshëm një diskriminim mjaft efecient. Me gjithë rezultatet e qarta keqtrajtimi i romëve nuk pranohet nga pjesa më e madhe e evropianolindorëve. Arsyeja për këtë i ka rrënjët thellë në imazhin që ata kanë për veten. Si mund të diskriminoj unë, si mund të diskriminojmë ne dikë? A mund të jetë kjo e mundur? Unë nuk kam as para, as pushtet! Ata e shohin veten të paktën po aq viktima sa dhe romët dhe mendojnë se nuk janë në gjendje të bëjnë padrejtësi, a për më tepër të shtypin dikë tjetër. Në rast se dikush ka në dorë